



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	Agj. Org.	4QP	Nr. Prot.	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	Org. Shërbime		Br. Prot.	44/18
MINISTRIA E FINANCËVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE	Org. Ligj		Prot. No.	
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGJENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	Nr. i Faqeve	1/2	Data :	
	Str. Stranica		Datum :	22.05.2018
	Nr. Pages		Date :	
			Prishtinë / a	

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansija - Ministry of Finance

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT

CENTRALNA AGJENCIA NABAVKE/CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

DATË/A:	22.05.2018
PËR/ZA/TO:	Autoritetet Kontraktuese/Njësitë Kërkuese dhe Kontraktuesit
CC;	Ministrinë e Punëve të Brendshme Lulzim Ejupi, Sekretar i Përgjithshëm në MPB Bekim Hoxha, Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Regjistrimit Civil, ARC Sebahate Muharremi, Drejtore e DRAPSH Departamentit Ligjor në MPB
Përmes /Through	Behxhet Rrukiqi, Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Qendrore të Prokurimit
NGA/OD/FROM:	Ekrem Rexha, Drejtor i Drejtoratit për Prokurime të Centralizuara
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për pajisje me targa zyrtare të automjeteve të marra me qira për Institucionet e Kosovës.

Të nderuar,

Agjencia Qendrore e prokurimit (AQP) funksionon sipas kompetencave të përcaktuara me LPP, Udhëzimin Administrativ 03/2017 dhe UA 06/2018 për prokurime qendrore, për nivel lokal dhe qendror, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës. Bazuar në këto kompetenca, AQP ka zhvilluar procedurën e prokurimit për marrjen me qira të automjeteve për institucionet e Republikës së Kosovës. Në dosje të tenderit dhe në kontratë janë përfshirë të gjitha përgjegjësitë e kontraktuesit, ku ndër tjera, është edhe regjistrimi i automjeteve ku kontraktuesit i kanë kryer obligimet e veta. Në nenin 20, paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018, për Regjistrimin e Automjeteve, përcaktohet, përveç librezës së regjistrimit të pronarit të automjetit, edhe shfrytëzuesi i automjetit. Ky udhëzim hyn në fuqi pas fillimit të implementimit të kontratave dhe si rrjedhojë, të gjitha institucionet duhet që të bartin **automjetet me tabela zyrtare** siç rregullohet me këtë Udhëzim Administrativ. Institucionet që vlerësojnë se ndonjë automjet duhet

Faqe 1 nga 2

Adresa: Ndërtesa e Gërmisë - Zona A kati IV /401-10.000 Prishtinë-Kosovë

Telefon/Faks: + 038 213 054

<http://aqp.rks-gov.net>

të ketë edhe/apo vetëm tabela civile, duhet ti drejtohen institucionit kompetent (MPB) që rregullohet me këtë udhëzim.

Nga kontraktuesi kërkohet që të dërgoj listën e automjeteve në MPB, përkatësisht tek znj. Sebahate Muharremi, me qëllim që të përgatiten targat zyrtare për çdo institucion. AQP do të informojë të gjitha njësitë kërkuese që shpenzimet prej 30 Euro t'i barten institucioneve që shfrytëzojnë automjetet për kalim nga tabelat civile në ato zyrtare, brenda 15 ditëve. Kontraktuesit duhet të informohen me kohë për ndërrimin e tabelave por jo më vonë se 15 ditë nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Shënim: Në rast se nuk veprohet sipas këtij njoftimi do të konsiderohet se automjetet nuk shfrytëzohen sipas udhëzimit në fuqi për shfrytëzim të automjeteve.

Ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni për çdo sqarim shtesë.

Me respekt,

Faqe 2 nga 2

Adresa: Ndërtesa e Gërmisë - Zona A kati IV / 401-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon/Faks: + 038 213 054
<http://aqp.rks-gov.net>